

U D H Ë Z I M
Nr. 3, datë 10.2.2004

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Në pjesën II “Autorizimi dhe miratimi”, bëhen këto ndryshime:

Në fund të pikës 2 “ Autorizimi për tatimpaguesit e akcizës “ shtohet paragrafi 2.12 si vijon:

2.12. Importuesit e maltos që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizim për importimin e maltos për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjecare me të drejtë përsëritje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme :

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore, si person i tatueshëm i TVSH-së;

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vetëekonomike;

c) Të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera;

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesit, si importues të maltos.

Importuesi i autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar, e cila do t’i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos tek tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos i gjenden sasi të maltos të padokumentuara ose vërtetohen shitje tek persona të paautorizuar si prodhues birre, për këto sasi ai detyrohet të paguajë 120 lekë për kg malto tatim, plus një gjobë në masën 100% të detyrimit dhe i hiqet e drejta e ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si importues birre. Organi tatimor ka të drejtë të mbajë këto shuma nga garancia e derdhur. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e shumave të mësipërme, tatimpaguesi paguan shumën totale, ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve në përputhje me ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

2. Në pjesën IV të udhëzimit, “Lëvizja e mallrave të akcizës”, bëhen këto ndryshime :

- Në pikën 13 “Lëvizja e mallrave të akcizës nga magazina tatimore nën regjimin e pezullimit tatimor”, në fund të paragrafit 13.4, shuma 100 000 lekë zëvendësohet me 300 000 lekë.

- Në pikën 14 “Marrja në dorëzim e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor në magazinën tatimore”, paragrafi 14.1 ndryshohet si me poshtë :

“14.1. Një magazinë tatimore mund të pranojë vetëm kategoritë e mëposhtme të mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor:

a) mallra akcizë që janë prodhuar apo ambalazhuar në Republikën e Shqipërisë dhe dërgohen apo livrohen nga një magazinë tjetër tatimore;

b) ngarkesat tregtare të mallrave që janë prodhuar apo ambalazhuar në Republikën e Shqipërisë dhe dërgohen apo livrohen nga një magazinë tjetër tatimore;

c) ngarkesat tregtare të mallrave të akcizës që janë importuar dhe që plotësojnë dispozitat e pikës 15 të udhëzimit.

- Në fund të paragrafëve 14.7 dhe 15.15, shuma 100 000 lekë zëvendësohet me 300 000 lekë.

3. Në pjesën IX “Proceset e përjashtuara dhe të miratuara”, bëhen këto ndryshime :

Në pikën 29.4. shkronja b ndryshohet si më poshtë:

“b. Është shoqëria furnizuese e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për akcizën e

paguar për karburantin e furnizuar personave që zotërojnë anije tregëtare peshkimi, që përdoren vetëm për udhëtime peshkimi.”.

Në pikën 29.8, fjalët “Organizata e menaxhimit të Peshkimit” zëvendësohet nga fjalët “Shoqëria furnizuese”.

4. Shtojca 22 C ndryshohet dhe bëhet si pasqyra bashkëngjitur.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fetoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

SHTOJCA 22 C – KËRKESA PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS (ANIJET E PËRSHKIMIT)

KËRKESA PËR KTHIMIN E AKCIZËS – KARBURANT PËR ANIJET E PESHKIMIT

Ju lutemi lexoni shënimet e bashkëngjitura përpara se të plotësoni këtë formular

1.Fundi i tremujorit:
Shih shënimin 1

Të dhënat e aplikantit: Shih shënimin 2		
Emri dhe NIPT-i:	2.	3. NIPT:
Adresa e organizatës:	4. Rruga Qyteti Rrethi	

Gazoili i furnizuar për përdorim në udhëtimet e peshkimit – shuma e mbartur nga fletet e tabelës bashkëlidhur []: Shih shënimin 3		
Sasia e përdorur (litrat) Shih shënimin 4	Vlera për akcizën/litër (Lek) Shih shënimin 5	13. Akciza e paguar për sasinë e përdorur Shih shënimin 6
5.	6.	7.

Unë deklaroj që lënda djegëse e shënuar në kutitë 5 dhe 9 më lart më është përdorur në udhëtime tregtare peshkimi, në përputhje me skemën që lejon rimbursimin e akcizës për karburantin e përdorur. Unë kam në dispozicion të dhënat e kërkuara nga ligji dhe udhëzimi për akcizat në fuqi që rregullojnë skemën e rimbursimit të akcizës dhe do t'i paraqesë ato sa herë që të kërkohet nga punonjësi i organit tatimor në mbështetje të kësaj kërkesë. Së bashku me këtë kërkesë po paraqes një tabelë të udhëtimeve tregtare të kryera dhe karburantit të blerë për ato udhëtime. Unë deklaroj që informacioni i dhënë në këtë dokument dhe në tabelë është i vertetë dhe i saktë.

Numri i fletëve me tabela që janë bashkëlidhur: 8.

Shih shënimin 7

Nënshkrimi dhe data: Emri dhe statusi: Shih shënimin 5, 6	Firma	Data
	Emri	Statusi

Për përdorim zyrtar	Data	Emri dhe firma
Data e marrjes së kërkesës		
* Verifikimi i pagesës së tatimit dhe mallrave të akcizës së përdorura në regjistrat e kërkuarit, nëse rezulton i rregullt, rekomandohet rimbursimi		
* I pakënaqshëm, kërkesa reduktohet në: Lekë		
Rimbursimi i miratuar		
Numri i urdhër pageses:		

(*Fshijeni sipas rastit)

SHËNIME PËR KËRKESËN E RIMBURSIMIT TË AKCIZËS – ANIJET E PESHKIMIT

- Shënim 1: Formulari i kërkesës duhet të dorëzohet çdo tre muaj, për tremujoret që përfundojnë në mars, qershor, shtator dhe dhjetor. Ju duhet të plotësoni një tabelë të karburantit të furnizuar për udhëtime tregtare të peshkimit dhe të paraqisni evidencën e blerjes së karburantit të furnizuar sipas rregullave të skemës.
- Shënim 2: Ju duhet të jeni një organizatë e regjistruar në administratën tatimore. Plotësoni kutitë 1 deri 7 të kësaj kërkesë, plotësoni tabelën, nënshkruani dhe vini datën e pastaj dorëzoheni në degën tuaj tatimore.
- Shënim 3: 1. Kërkesa juaj do të verifikohet kundrejt të dhënave që mbani, kështu që në ditarin e udhëtimit duhet të mbahen shënime të kujdesshme për karburantin që u është furnizuar anijeve të peshkimit dhe të regjistrohen të dhëna për udhëtimet përkatëse të shënuara në regjistrin e anijeve të peshkimit, duke përfshirë edhe të dhënat për sasinë e peshkut të zënë.
2. Sigurohuni që furnizuesi juaj i karburantit t'ju pajisë me fatura që kanë numër dhe datë, të cilat tregojnë sasinë e tatueshme të ngarkesës dhe tatimin e paguar dhe dorëzoheni faturën së bashku me këtë kërkesë.
3. Shënoni numrin e fletëve të tabelave që po i bashkëngjisni formularit të kërkesës.
- Shënim 4: Shënoni sasinë faktike të karburantit që është furnizur për udhëtimet tregtare të peshkimit nga totali i tabelave të bashkëngjitura.
- Shënim 5: Vlera e akcizës së gazolit do të jetë vlera e paraqitur në faturën që keni marrë nga furnizuesi juaj. Shënoni këtë vlerë në tabelë, ndërsa përdorni karburantin, duke përdorur së pari furnizimin fillestar. Shënoni vlerën gjithsej në kutinë 6 të këtij formulari.
- Shënim 6: Shënoni tatimin që kërkohet të kthehet.
- Shënim 7: Shënoni numrin e fletëve me tabela që i bashkëngjiten këtij formulari.
- Shënim 8: 1. Nëse firmosni deklaratën, ju duhet të jeni të autorizuar të veproni në emër të organizatës së përmendur.
2. Bërja e një deklarate të rremë për qëllimin e sigurimit të një rimbursimi, përbën shkelje. Dhe do të rezultojë në vënien e gjobave. Shënimet në këtë formular kanë forcë ligjore.
- Shënim 9: Shënoni në tabelë çdo blerje karburanti sipas datës dhe pastaj përcaktoni sasinë e karburantit të blerë për çdo furnizim. Vlera e karburantit të përdorur do të jetë vlera për litër në faturë. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme në tabelë përdorni fletën vijuese, shënoni numrin e faqeve të përdorura, kapeni fletën vijuese në formularin e kërkesës dhe kaloni shumat totale në kutinë 7.